



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1440 prot.

Ballsh më, 02.04.2025

VENDIM

Nr. 10, Datë 26/03/2025

“PËR MIRATIMIN E AKORDIMIT TË VLERËS FINANCIARE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË FUNERALIT TË TË NDJERËVE SABRI VELAJ DHE NOVRUS VELAJ, FSHATI ÇORRUSH, NJËSIA ADMINISTRATIVE KUTË, BASHKIA MALLAKASTËR”.

Në zbatim të nenit 3 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 6/b, pika 2 e Ligjit 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për Miratimin e Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak”,

VENDOSI

1. Miratimin e akordimit të vlerës financiare totale prej **160 000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh** për mbulimin e shpenzimeve të funeralit të të ndjerëve **Sabri Velaj** dhe **Novrus Velaj**, fshati Çorrush, Njësia Administrative Kutë, Bashkia Mallakastër, të cilët ka ndërruar jetë më datë 03.02.2025, ndodhur në kushtet e nenit 6/b, pika 2 e Ligjit 9220, datë 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, “Kur detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, është i pamundur, shpenzimet e shërbimit të varrimit kryhen nga njësia bazë e qeverisjes vendore ku ai është i regjistruar”.
2. Vlera merret përsipër nga buxheti i Bashkisë Mallakastër në artikullin 606, zëri “fond i veçantë”, planifikuar në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë Mallakastër.
3. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

